



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

**Prishtinë, më 7 korrik 2023**  
**Nr. Ref.: KK 233/23**

Në pajtim me paragrafin 2 të nenit 112 [Parimet e Përgjithshme], paragrafin 1 të nenit 115 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 2 (Organizimi i punës së Gjykatës Kushtetuese), nenin 10 (Detyrat e gjyqtarëve) dhe nenin 11 (Kryetari dhe Zëvendës Kryetari) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me nënparagrafët (a) dhe (b) të paragrafit 1 të rregullit 10 (Funksionet e Kryetarit) dhe paragrafin 1 të rregullit 14 (Seancat Administrative) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese nr. 01/2018, të miratuar më 31 maj 2018, përkatësisht nënparagrafët (a) dhe (b) të paragrafit 2 të rregullit 10 (Detyrat e Kryetarit/es) dhe paragrafin 1 të rregullit 14 (Seancat Administrative) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese nr. 01/2023, të miratuar më 27 qershor 2023, si dhe në zbatim të Vendimit Nr.Ref.KK224-8/21, të datës 6 shtator 2021, të plotësuar dhe ndryshuar përmes Vendimit Nr.Ref.KK.205/23 të datës 12 qershor 2023, për ndryshimin dhe konsolidimin e Kodit të Etikës për Gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Kushtetuese, pas seancës administrative të datës 27 qershor 2023, miraton këtë:

## **KODI I ETIKËS**

### **PËR GJYQTARËT E GJYKATËS KUSHTETUESE**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Ky Kod shërben si udhëzues për sjelljen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe është i prirë nga respektimi dhe lartësimi i vlerave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mbrojtja dhe avancimi i drejtësisë e sundimit të ligjit dhe mbrojtja e të drejtave e lirive themelore të njeriut.
2. Gjyqtarët janë të detyruar të veprojnë gjithmonë sipas standardeve më të larta të sjelljes etike dhe profesionale përgjatë ushtrimit të funksioneve dhe veprimtarisë së tyre brenda Gjykatës Kushtetuese dhe gjithashtu në veprimtarinë e tyre jashtë Gjykatës Kushtetuese.

## **Neni 2**

### **Parimet e përgjithshme**

1. Gjyqtarët duhet t'i ushtrojnë detyrat dhe funksionet e tyre në përputhshmëri me betimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese siç është përcaktuar në nenin 7 (Emërimi dhe fillimi i mandatit) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
2. Gjyqtarët kanë për detyrë të ushtrojnë me ndërgjegje dhe në mënyrë të paanshme funksionin e gjyqtarit/es dhe të vendosin sipas bindjes së lirë në pajtim me Kushtetutën, si dhe kanë për detyrë të ruajnë reputacionin dhe dinjitetin e Gjykatës Kushtetuese, siç është përcaktuar në nenin 10 (Detyrat e gjyqtarëve) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
3. Secili/a gjyqtar/e ka për detyrë të marr pjesë në punën dhe procesin e vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese, si dhe të kryej punët tjera të caktuara me ligj dhe me Rregulloren e punës, siç është përcaktuar në nenin 10 (Detyrat e gjyqtarëve) dhe nenin 19 (Marrja e Vendimeve) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
4. Gjyqtarët duhet të ushtrojnë funksionet dhe veprimtarinë e tyre me pavarësi, integritet, dinjitet dhe paanshmëri të plotë, me nivel të lartë konfidencialiteti dhe besnikërie ndaj detyrës dhe të ruajnë çdoherë besimin e qytetarëve në drejtësi dhe në Gjykatën Kushtetuese.
5. Gjyqtarët duhet të demonstrojnë standardet më të larta të sjelljes profesionale dhe etike, duke përfshirë mirësjelljen, kolegialitetin dhe respektin në mënyrën e të shprehurit gjatë ushtrimit të funksionit të tyre si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, si dhe duhet të sigurohen që veprimet dhe deklaratimet e tyre të jenë gjithmonë profesionale dhe në respektim të plotë të parimit të kolegialitetit dhe dinjitetit të tjetrit/es.
6. Gjyqtarët duhet të demonstrojnë të njëjtat standarde përgjatë ndërveprimit me palët në procedurë, përfaqësuesit e tyre dhe personave tjerë me të cilët ndërveprojnë në kapacitet zyrtar e personal.

## **Neni 3**

### **Pavarësia**

1. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre gjyqësore, gjyqtarët duhet të jenë të pavarur nga çdo institucion, autoritet publik apo nga çdo subjekt privat.
2. Gjyqtarët duhet të mos i nënshtrohen asnjë ndikimi të çfarëdo lloji, qoftë të jashtëm apo të brendshëm, qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Ata duhet të përmbahen nga çdo aktivitet, shprehje dhe asociim dhe duhet të refuzojnë të ndjekin çfarëdo udhëzimi dhe të shmangin çdo situatë që mund të konsiderohet se ndërhyr në funksionin e tyre gjyqësor ose ndikon negativisht në besimin e publikut në pavarësinë e tyre.

#### **Neni 4 Paanshmëria**

1. Gjyqtarët duhet të ushtrojnë funksionet e tyre gjyqësore në mënyrë të paanshme, të drejtë e të barabartë, pa paragjykime dhe pa anshmëri bazuar në racë, gjini, përkatësi etnike, orientim seksual apo çdo status tjetër personal.
2. Gjyqtarët nuk duhet të ndërmarrin asnjë veprim apo të shprehen në ndonjë mënyrë që mund ngritë dyshim të arsyeshëm përkitazi me pavarësinë dhe paanësinë e tyre dhe që mund të ndikojë në besimin e qytetarëve në pavarësinë, integritetin dhe dinjitetin e funksionit të tyre.
3. Gjyqtarët duhet të tregojnë kujdesin më të lartë dhe të shmangin çfarëdo ndërveprimi me palë ose persona të ndërlidhur me lëndët në shqyrtim e sipër.
4. Nëse gjyqtarët vlerësojnë që janë plotësuar kushtet për përjashtim siç janë përcaktuar në nenin 18 (Përjashtimi i gjyqtarit) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 38 (Procedura për përjashtimin e gjyqtarëve) të Rregullores së punës nr. 01/2023 apo besojnë se ekzistojnë rrethana që ngrenë dyshim të arsyeshëm përkitazi me paanësinë e tyre, gjyqtarët duhet të kërkojnë përjashtimin nga pjesëmarrja në procedurë sipas dispozitave përkatëse të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregullores së saj të punës. Për më tepër, gjyqtarët duhet të evitojnë çdo situatë që mund të ngritë dyshime rreth ndonjë konflikti të interesit apo edhe mund të perceptohet si e tillë.
5. Gjyqtarët nuk duhet të shfrytëzojnë prestigjin e pozitës së tyre gjyqësore për ndonjë përfitim personal. Gjyqtarët nuk duhet të pranojnë asnjë dhuratë, favor ose avantazh, për vetveten ose për ndonjë anëtar të familjes që mund të ndërlidhet me detyrat ose funksionet e tyre. Kjo vlen njësoj, por nuk kufizohet, edhe në dhurata vlerësimi ose mikpritjeje, me përjashtim të dhuratave protokollare me vlerë modeste.

#### **Neni 5 Integriteti**

Sjellja e gjyqtarëve duhet të jetë në përputhje me karakterin e lartë moral që është kriter për funksionin e tyre gjyqësor. Gjyqtarët duhet të jenë të vetëdijshëm gjatë gjithë kohës për detyrën e tyre dhe të veprojnë me integritet dinjitet, besnikëri dhe diskrecionin e duhur në ruajtje të autoritetit dhe reputacionit të Gjykatës Kushtetuese.

#### **Neni 6 Konfidencialiteti**

1. Gjyqtarët janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e informatave jopublike, të klasifikuara apo të mbrojtura me ligj, të cilat i marrin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre gjyqësore, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në ato të përcaktuara me rregullin 61 (Konfidencialiteti) dhe rregullin 52 (Këshillimi) dhe rregullin 53 (Votimi) të Rregullores së punës nr. 01/2023.

2. Gjyqtarët duhet të ruajnë fshehtësinë e këshillimeve dhe të votimit dhe gjithnjë të veprojnë dhe të shprehen me vetpërmbytjen e duhur që e kërkon funksioni i tyre.
3. Gjyqtarët nuk duhet t'ia transmetojnë askujt jashtë Gjykatës Kushtetuese informatat konfidenciale, qoftë me dashje apo nga pakujdesia, duke përfshirë por pa u kufizuar në informata në lidhje me lëndët, diskutimet e zhvilluara gjatë këshillimit dhe seancave jopublike, informatat jopublike në lidhje me administrimin e brendshëm, si dhe çdo informatë tjetër të mbrojtur me ligj dhe të përfituar gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit/es.

### **Neni 7 Besnikëria**

1. Gjyqtarët duhet të respektojnë detyrimin e tyre për besnikëri ndaj Gjykatës Kushtetuese.
2. Gjyqtarët do të përdorin shërbimet e zyrtarëve dhe të nëpunësve të tjerë të institucionit në mënyrë të arsyeshme dhe të respektueshme.
3. Gjyqtarët duhet të menaxhojnë me resurset materiale të institucionit në mënyrë të përgjegjshme.
4. Gjyqtarët duhet të përmbahen nga dhënia e çfarëdo deklarate jashtë institucionit që mund të dëmtojë reputacionin e tyre.

### **Neni 8 Aftësitë profesionale**

1. Gjyqtarët duhet t'i kryejnë detyrat e tyre me përkushtim të plotë, me zell, profesionalizëm dhe kujdes të lartë, në mënyrë të drejtë dhe efikase dhe në përputhje të plotë me Kushtetutën, legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës dhe rregullativën e brendshme të Gjykatës Kushtetuese.
2. Gjyqtarët duhet të jenë të përkushtuar që në vazhdimësi t'i rrisin aftësitë dhe njohuritë e tyre profesionale dhe të angazhohen për të qenë të informuar për zhvillimet më të reja në lëmin e drejtësisë kushtetuese dhe jurisprudencën përkatëse vendëse, rajonale dhe ndërkombëtare.

### **Neni 9 Liria e shprehjes**

1. Gjyqtarët duhet të ushtrojnë lirinë e tyre të shprehjes në mënyrë të pajtueshme me funksionin e tyre gjyqësor, me besnikëri ndaj Gjykatës Kushtetuese dhe në mënyrë të atillë që nuk cenon dinjitetin, reputacionin dhe autoritetin e gjyqtarëve tjerë dhe Gjykatës Kushtetuese dhe besimin e qytetarëve në Gjykatën Kushtetuese.

2. Gjyqtarët duhet të përmbahen nga çfarëdo reagimi, shprehje e mendimeve dhe komente lidhur me lëndët në shqyrtim në Gjykatë Kushtetuese, në çfarëdo forme, para publikimit të një vendimi përfundimtar.
3. Gjyqtarët duhet të përmbahen nga reagimet, shprehjet e mendimeve dhe komentet lidhur me vendimet e publikuara të Gjykatës Kushtetuese dhe punën e saj në përgjithësi, në çfarëdo forme që mund të cenojnë dinjitetin dhe reputacionin e gjyqtarëve tjerë dhe Gjykatës Kushtetuese, si dhe besimin e qytetarëve në Gjykatën Kushtetuese. Kjo vlen njësoj si për ushtrimin e funksionit gjyqësor e përfaqësimin e Gjykatës Kushtetuese edhe për aktivitete akademike ose aktivitete të tjera publike ose private jashtë Gjykatës Kushtetuese.
4. Mendimet Mospajtuese dhe Konkurruese të gjyqtarëve të Gjykatës duhet gjithnjë të jenë në përputhje me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, Rregulloren e punës, këtë Kod të Etikës dhe standardet e vendosura përmes Opinioneve të Komisionit të Venecias. Shprehja e mendimit ndryshe në këto mendime të ndara, duhet gjithnjë të reflektojë besnikërinë ndaj Gjykatës Kushtetuese dhe ruajtjen e autoritetit, dinjitetit dhe kredibilitetit të të gjithë gjyqtarëve dhe Gjykatës Kushtetuese.
5. Gjyqtarët duhet të tregojnë kujdesin më të lartë në përdorimin e mediave sociale.

#### **Neni 10** **Veprimtaritë shtesë**

1. Gjyqtarët duhet t'i japin përparësi punës së tyre si gjyqtarë dhe çfarëdo angazhimi shtesë i gjyqtarëve duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me pavarësinë, paanësinë dhe detyrat e tyre të punës si gjyqtarë.
2. Gjyqtarët nuk mund të angazhohen në asnjë lloj aktiviteti shtesë, fitimprurës ose jo, që është i papajtueshëm me funksionin e tyre siç është përcaktuar në nenin 5 (Pajtueshmëria e funksionit) të Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.

#### **Neni 11** **Zbatimi i Kodit pas përfundimit të mandatit si gjyqtarë**

1. Dispozitat e këtij Kodi vazhdojnë të vlejnë për gjyqtarët edhe pas përfundimit të mandatit të tyre si gjyqtarë, për aq sa ato janë të zbatueshme. Gjyqtarët vazhdojnë të jetë të obliguar të veprojnë me integritet, dinjitet, besnikëri ndaj Gjykatës Kushtetuese dhe në respektim të obligimit për konfidencialitet, edhe pas përfundimit të mandatit si gjyqtarë.
2. Gjyqtarët duhet të përmbahen nga reagimet, shprehjet e mendimeve dhe komentet lidhur me vendimet e publikuara të Gjykatës Kushtetuese dhe punën e saj në përgjithësi, në çfarëdo forme, që mund të cenojnë dinjitetin dhe reputacionin e gjyqtarëve tjerë dhe Gjykatës Kushtetuese, si dhe besimin e qytetarëve në Gjykatën Kushtetuese, edhe pas përfundimit të mandatit si gjyqtarë.

## **Neni 12** **Interpretimi dhe zbatimi**

1. Interpretimi i këtij Kodi bëhet ekskluzivisht nga Gjykata Kushtetuese, në frymën e standardeve dhe rregullave ndërkombëtare që qeverisin etikën dhe mirësjelljen e gjyqtarëve.
2. Kryetari/ja i/e Gjykatës Kushtetuese themelon një Komision Konsultativ të përbërë nga tre (3) gjyqtarët më të vjetër në detyrë, siç përcaktohet në rregullin 11 (Përparësia e gjyqtarëve) të Rregullores së punës nr. 01/2023. Kryetari/ja i/e Gjykatës Kushtetuese, i ndihmuar nga Komisioni Konsultativ, është përgjegjës/e për sigurimin e zbatimit të duhur të këtij Kodi të Etikës.
3. Nëse objekt vlerësimi dhe interpretimi është sjellja e Kryetarit/es, Zëvendëskryetari/ja do të zëvendësojë Kryetarin/en, ndërsa Komisionit Konsultativ do t'i shtohet një anëtar/e shtesë, përkatësisht gjyqtari/ja i/e radhës më i/e vjetër në detyrë. Ndërsa, nëse sjellja e një anëtari/eje tjetër të Komisionit Konsultativ është objekt vlerësimi dhe interpretimi, anëtari/ja në fjalë i/e Komisionit Konsultativ, do të zëvendësohet nga gjyqtari/ja i/e radhës më i/e vjetër në detyrë. Pa cenuar dispozitat e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe të Rregullores së punës, Komisioni Konsultativ, në një rast individual, mund t'i japë mendimin përkatës gjyqtarit/es ose ish-gjyqtarit/es në fjalë pasi ta dëgjojë atë.

## **Neni 13** **Hyrja në fuqi**

1. Ky Kod hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit, pas miratimit me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve në seancë administrative.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi, shfuqizohet Kodi i Mirësjelljes për Gjyqtarë, i miratuar në vitin 2013.

Prishtinë, më 7 korrik 2023

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Gresa Caka-Nimani

